



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE E RINISË

Nr. 1581 Prot.
Datë 09.03. 2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 2546 Prot.
Datë 10.3. 2017

U D H Ë Z I M

Nr. 6, datë 09.03. 2017

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 29.12.2016 "PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË MATURËS SHTETËRORE 2017"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51 të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 13 të Ligjit Nr. 8872, datë 29.03.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J M Ë:

1. Në Udhëzimin e MAS dhe MMSR Nr. 26, datë 29.12.2016 "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të maturës shtetërore 2017", në "Listën e lëndëve të provimeve me zgjedhje", të përcaktuara në pikën 2, te grupi i lëndëve III "Shkollat profesionale" (pika 2.1), të shtohen si vijon:
 27. "Zhvillim website", me numër kreditesh 8.
 28. "Sigurime", me numër kreditesh 8.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Zëvendësministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i MAS, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit,

Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

BLENDI KLOSI


MINISTËR

LINDITA NIKOLLA
